

E DREJTA PËR INFORMIM

Shqipëria vlerësohet për përputhshmërinë e ligjit “Për të drejtën e informimit” me Konventën e Tromsø-s

Në takim të 5-të të Konsultimit të Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” (Konventa e Tromsø-s) u vlerësua se, ligji shqiptar për të drejtën e informimit (LDI) është në përputhje me parimet dhe standardet e përcaktuara në këtë dokument. Konsultimi mirëpriti zbatimin e gjerë të ligjit në autoritetet publike shqiptare, garantimin e qasjes në informacion/dokumentacion me karakter publik për të gjithë qytetarët pa diskriminim, ashtu si edhe respektimin e parimeve të transparencës dhe qeverisjes së hapur.



Në të njëjtën kohë, u rekomandua që Shqipëria të përmirësojë më tej dispozitat ligjore për të siguruar përputhshmërinë e përjashtimit mbi sekretin profesional me nenin 3 të Konventës, si dhe përcaktimin e qartë të së drejtës së kërkuesit për të zgjedhur formën e marrjes së dokumenteve zyrtare. Këto rekomandime pritet të kontribuojnë për forcimin e mëtejshëm në vendin tonë të transparencës dhe aksesit të publikut në informacion.

Një vendim i rëndësishëm i takimit lidhet me zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Grupit të Aksesit në Informacion të Këshillit të Evropës (grupi i ekspertëve për vlerësimin e përputhshmërisë me parashikimet e Konventës), për një mandat katërvjeçar, që nis më 1 prill 2026. Në mesin e tyre u rizgjodh edhe znj. Elona Hoxhaj, Drejtor i Përgjithshme për të Drejtën e Informimit në Zyrën e Komisionerit. Ky zhvillim thekson rolin aktiv të Shqipërisë në mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit dhe zbatimit të Konventës.

Përmirësimi i Programit të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore në proces konsultimi publik

Zyra e Komisionerit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 119/21014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (neni 6), parashitroi për konsultim përgjatë muajit tetor 2025 projektin e ri të Programit model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV). Nëpërmjet këtij procesi është synuar të përmirësohen akoma më shumë standardet e transparencës proaktive në nivel vendor. Njëkohësisht, modeli i ri i Programit të Transparencës është përshtatur me ndryshimet ligjore dhe me zhvillimet më të fundit në fushën e të drejtës për informim, të dhënave të hapura dhe pjesëmarrjes qytetare në qeverisje.

Procesi i konsultimit ka qënë i hapur për qytetarët, bashkitë dhe këshillat bashkiakë, si dhe organizatat e shoqërisë civile. Konsultimi ka për qëllim të sigurojë që dokumenti/modeli përfundimtar të pasqyrojë praktikën më të mirë të transparencës, qasjes së lehtë në informacion dhe rritjes së llogaridhënies në nivel vendor.

Në vijim të këtij procesi, Zyra e Komisionerit zhvilloi një aktivitet me përfaqësues të Këshillit Bashkiak dhe administratës së Bashkisë Shijak. Ky aktivitet u mbajt pas takimit të parë të zhvilluar në qytetin e Lezhës, në funksion të bashkëpunimit dhe përfshirjes së autoriteteve vendore në përmirësimin e kuadrit të transparencës.



Pjesëmarrësit u njohën me ndryshimet dhe përmirësimet e propozuara në Programin e Transparencës së NJVV, të cilat u prezantuan nga Drejtori i Përgjithshëm i të Drejtës për Informim, znj. Elona Hoxhaj. Përfaqësuesit e Bashkisë Shijak paraqitën, gjithashtu, propozime dhe sugjerime të vlefshme, që kishin të bënin kryesisht me transparencën ekonomiko-financiare apo dhe me informacionin që duhet të publikohet nga këshillat bashkiakë.

Përmirësimi i Programit të Transparencës së NJVV synon të garantojë gjithëpërfshirjen, ta bëjë kërkimin e informacionit sa më praktik, por edhe të përshtatet gjithnjë e më shumë me nevojat reale të njësive të vetëqeverisjes vendore, duke rritur njëkohësisht standardet e hapjes dhe llogaridhënies publike.

Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2025, ka dalë me disa vendime në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.


Vendim nr . 36, datë 27.10.2025, Për urdhërimin e autoritetit publik Agjencia Kombëtare e Rinisë për dhënie informacioni/ dokumentacioni

Vendim nr . 37, datë 30.10.2025, Për urdhërimin e autoritetit publik Bashkia Tiranë për dhënie informacioni/dokumentacioni

Zhvillohet takimi i 4-t i Komitetit Ekzekutiv të ICIC

Nën drejtimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, u zhvillua mbledhja e katërt plenare e Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Në fokus të diskutimeve ishte konstituimi i Komitetit të Planifikimit për organizimin e Konferencës në vitin 2026.

Komiteti Ekzekutiv vendosi që në këtë strukturë të përfshihen edhe përfaqësues të shoqatave dhe organizatave ndërkombëtare, përveç anëtarëve të ICIC. Ndër këto organizata, u veçuan UNESCO, si partner kryesor i organizatës, OECD, Qendra për Ligj dhe Demokraci nga Kanadaja, si dhe aktorë të tjerë me rol të rëndësishëm në fushën e së drejtës për informim. Ky vendim synon të pasurojë procesin e planifikimit me ekspertizë të zgjeruar dhe të kontribuojë në hartimin e një programi sa më gjithëpërfshirës për sesionin e hapur të Konferencës.



Në këtë sesion morën pjesë gjithashtu përfaqësues të UNESCO-s dhe Komisionerit të Informimit të Britanisë së Madhe (ICO), të cilët paraqitën nismën për promovimin e dokumentit të parimeve të së drejtës për informim, të miratuar në Konferencën e Berlinit në qershor 2025. Përfaqësuesi i UNESCO-s paraqiti një panoramë të hapave të parashikuar për avancimin e kësaj nisme dhe kërkoi mbështetjen e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të ICIC për promovimin e saj në rrugë diplomatike, përfshirë autoritetet shtetërore kompetente, me synimin e miratimit të dokumentit në OKB. Zyra e Komisionerit vlerësoi këtë iniciativë dhe shprehu gatishmërinë për ta mbështetur këtë nismë.

Në vijim, Zyra e Komisionerit prezantoi Buletinin Special të organizatës, të hartuar në cilësinë e Presidencës dhe Sekretariatit të ICIC. Ky produkt përmbledh iniciativat dhe projektet e vendeve anëtare të ICIC në kuadër të krenimit të 28 Shtatorit - Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim (IDUAI) dhe synon të shërbejë si instrument informues për promovimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

“Initiative 2020”, Dervishi: “E drejta për informim mjet kyç për të rritur besimin e publikut dhe për të forcuar demokracinë”



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi dhe Drejtoresha e Përgjithshme e të Drejtës për Informim, znj. Elona Hoxhaj, me ftesë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës (AIP) morën pjesë në workshopin rajonal me temë “INITIATIVE 2020”.

Ky aktivitet bëri bashkë përfaqësues të autoriteteve për të drejtën e informimit nga vendet e Evropës dhe rajonit, me qëllim ndarjen e praktikave dhe eksperiencave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e aksesit në dokumentet publike.

Komisioneri Dervishi, në cilësinë edhe të Presidentit të Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën për Informim (ICIC), theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar midis rrjeteve rajonale dhe organizatave globale që mbështesin transparencën dhe lirinë e informacionit. Ai tha se ICIC, si organizata më e madhe botërore në këtë fushë, ka për qëllim të ndërtojë kapacitete, të promovojë praktikën më të mira dhe të forcojë zërin kolektiv të autoriteteve që garantojnë të drejtën e qytetarëve për informim publik dhe llogaridhënie.

“E drejta për informim është një mjet kyç për të rritur besimin e publikut dhe për të forcuar demokracinë. Ajo garanton kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisjes nga qytetarët dhe përbën një mekanizëm thelbësor për funksionimin e një shoqërie demokratike” – u shpreh z. Dervishi.

Më tej ai ndau prioritetet strategjike të organizatës për periudhën 2024–2027, të cilat fokusohen në forcimin e kapaciteteve të rrjetit ndërkombëtar, zgjerimin e anëtarësisë, intensifikimin e dukshmërisë globale dhe konsolidimin e bashkëpunimit me rrjetet rajonale dhe grupet e punës.

Znj. Krenare Sogojeva-Dërmaku, Komisionere e Kosovës, shprehu vlerësime për Zyrën e Komisionerit, si dhe apeloj për më shumë bashkëpunim ndërkombëtar mes institucioneve homologe dhe organizatave rajonale të fushës me synim forcimin e transparencës.

Ndërsa, Drejtoresha e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit Znj. Elona Hoxhaj, bëri një përmbledhje të situatës së transparencës proaktive të autoriteteve publike në Shqipëri, si dhe ndau me pjesëmarrësit instrumentin e Programit dhe Indeksit të Transparencës.

Bashkëpunimi i Zyrës së Komisionerit me shoqërinë civile



Zyra e Komisionerit ishte e ftuar në tryezën e rrumbullakët “Shoqëria civile për shëndetësi cilësore dhe arsim të barabartë - Transformimi i komuniteteve në Shqipëri”. Ky aktivitet u mbajt nën organizimin e shoqatës “Together for Life” (TfL), në kuadër të projektit SPACE “Mbështesim pjesëmarrjen, përgjegjësinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”.

Tryeza mbledhi bashkë përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve të pavarura të drejtave të njeriut dhe pushtetit vendor, ku organizatat lokale përfituese të nëngranteve prezantuan sfidat dhe rezultatet e më shumë se 12 nismave të zbatuara në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë në 11 bashki të vendit. Në fokusin e tyre ishte rritja e ndërgjegjësimi dhe aktivizmit qytetar, adresimi i problemeve që prekin komunitetet, sidomos grupet vulnerabël, si dhe monitorimi i pjesëmarrjes qytetare në hartimin e politikave dhe buxheteve publike lokale. Këto nisma kanë synuar për të kontribuar në përmirësimin e qeverisjes vendore, rritjen e transparencës dhe forcimin e pjesëmarrjes në qeverisje.

Në këtë takim, Zyra e Komisionerit u përfaqësua nga znj. Emerlinda Pema, Drejtore e Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës, e cila vlerësoi bashkëpunimin e deri tanishëm dhe ndërveprimin me organizatat e shoqërisë civile, ndërsa garanoi se institucioni ka qenë dhe mbetet i angazhuar për rritjen e llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe transparencës së autoriteteve publike.

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian dhe u zbatua nga shoqata “Together for Life”, në bashkëpunim me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare dhe Destiny for Civil Empowrment (DCE).



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:

